



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 11.01.2013
Nr. 0204-1294

PËR: Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
Xhemali Haxhimustafa, Kryesues i Kuvendit të Komunës Rahovecit

LËNDA: Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimeve të Komunës së Rahovecit, Nr.01-4622 dhe Nr.01-4682

Të nderuar/a


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit për dhënien në shfrytëzim të tregjeve dhe Vendimin për lejimin e kontratës për qiradhënie nga Komuna e Rahovecit **KONSTATON** se:

- Vendimi është në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin të Pronës së Paluajtshme të Komunës, i cili ka përcaktuar se dhënies se pronës së paluajtshme të Komunës në afat të shkurtër bëhet në formë të konkursit të hapur përmes ankandit publik.
- Për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në afat të shkurtër ankandi duhet të jetë i hapur jo me pak se 30 (tridhjetë) ditë, si dhe themelohet komisioni vlerësues në përbërje të ekzekutivit dhe legjislativit të komunës prej 7 (shtatë) anëtarëve i cili përcjell konkursin që nga fillimi e deri në dorëzimin e ofertës së përzgjedhur për votim në Kuvendin e Komunës, ashtu siç e përcakton neni 5 i Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin të Pronës së Paluajtshme të Komunës

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale *kërkon* nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Rahovecit që të ndërmarrin veprime konkrete që Vendimin Nr.01-4622 për dhënien në shfrytëzim të tregjeve, si dhe Vendimin Nr.01-4682 për lejimin e kontratës për qiradhënie të harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Me respekt,
Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Drejtorëve të Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 11.01.2013
Br. 0204-1294

Za : Smajl Latifi, Gradonačelnik Opštine Orahovac
Xhemali Haxhimustafa, Predsedavajući Skupštine Opštine Orahovac

PREDMET: Zahatv za razmatranje zakonitosti Odluka ,Opštine Orahovac
br.01-4622 i br.01-4682

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim prema Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Vladine Uredbe 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posla razmatranja zakonitosti Odluke za davanje na korišćenje tržišta i Odluku za dozvolu ugovora za davanje pod kirijom od strane Opštine Orahovac **KONSTATUJE:**

- Odluka je u suprotnosti sa članom 5 Zakona br.04/L-144 za davanje na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine, koji je odredio da davanje nepokretne opštinske imovine u kratkom vremenskom roku se vrši u formi otvorenog konkursa preko javnog nadmetanja.
- Za davanje nepokretne opštinske imovine u kratkom vremenskom roku nadmetanje treba da bude otvoreno ne manje od 30 (trideset) dana, osniva se komisija za procenjivanje u sastavu izvršne i zakonodavne vlasti opštine od 7 (sedam) članova koji prati konkurs od početka do predaje izvršene ponude za glasanje u Skupštinu Opštine, onako kako predviđa sa članom Zakon br.04/L-144 za davanje na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu člana 82 tačka 2 Zakona o lokalnoj samoupravi *traži* od Skupštine Opštine/Gradonačelnika Opštine Orahovac da preduzmu konkretne mere da Odluku br.01-4622 za **davanje na korišćenje** tržišta , kao i Odluku br.01-4682 o odobrenju ugovora za davanje pod kirijom da uskladi sa zakonskim dispozicijama na snazi, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za ponovno razmatranje akta .

S poštovanjem,
Slobodan Petrović,
Zamanik Premijera i Ministar MALS,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS
Direktorima uprava i kancelarija
Arhivi MALS-a.



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Në bazë të nenit 13 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës 03/L-040 dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vetë të mbajtur më datë 30.2012, merr këtë

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHSHËM TË TREGJEVE
NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Neni 1

Me këtë vendim jepet Organizatës së Veteranëve të Luftës - Dega në Rahovec, në shfrytëzim të përkohshëm – njëvjeçar të tregjeve në Komunën e Rahovecit dhe atë në Rahovec, Ratkoc dhe Krushë të Madhe.

Neni 2

Dega e OVL në Rahovec, do të caktojë punëtorë të cilët do të bëjnë inkasimin dhe menaxhimin e tregjeve në Rahovec, Ratkoc dhe Krushë të Madhe

Neni 3

Tarifat për shfrytëzimin e hapësirës në këto tregje propozon Dega e OVL-së ndërsa aprovimin e tyre e bënë Kuvendi Komunal.

Neni 4

Kontrollimin e inkasimit e të hyrave nga këto tregje do të bëjë Njësia e auditimit të brendshëm e Komunës së Rahovecit.

Neni 5

Punëtorët e Degës së OVL obligohen që në rast të mos zbatimit të këtij vendimi nga ana e qytetarëve dhe kompanitë tjera, të lajmërojnë Policinë e Kosovës – Stacioni në Rahovec dhe Drejtorinë për Punët Inspektuese.

Neni 6

Dega e OVL në Rahovec në afatin e përcaktuar për shfrytëzimin e këtyre tregjeve nuk ka obligim të qiradhënies ndaj Komunës së Rahovecit.

Neni 7

Të hyrat të cilat do të inkasohen nga tregjet e lartë cekura do t'i menaxhoj Dega e OVL në Rahovec.

Neni 8

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtoria për Shërbime Publike Komunale dhe Emergjencë, Drejtoria për Punët Inspektuese dhe Dega e OVL në Rahovec.

Neni 9

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit të tij.

01 Nr. 4622

Rahovec, 30.10.2012

Kuvendi i Komunës së Rahovecit



Kryesuesi i Kuvendit

Shemali Haxhimustafa



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Në bazë të nenit 12 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale të Komunave të Kosovës dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 30 tetor 2012, të marr këtë

V E N D I M

PËR LEJIMIN E VAZHDIMIT TË KONTRATËS PËR QIRADHËNIE

Neni 1

Me këtë vendim autorizohet Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Rahovecit, që të vazhdojë kontratën mbi qiradhënie të objektit hotelier të "Ura e fshenjtë" në Xërxë dhe atë në afat prej 6 muaj prej ditës së marrjes së këtij vendimi respektivisht prej 1 nëntor 2012 deri më 30 prill 2013.

Neni 2

Obligohet Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Rahovecit, që në afat të duhur të përgatitë dokumentacion dhe të parashikoj kriteret për shpalljen e tenderit të dhënies me qira të këtij objekti shoqëror.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim e komunës së Rahovecit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi prej ditës së marrjes së tij ndërsa do të aplikohet prej 1 nëntor 2012.

01 Nr. 4682
Rahovec, 30.10.2012

Kuvendi i Komunës së Rahovecit



Kryesuesi i Kuvendit

Xhemali Haxhimustafa